



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 150 – Maj – 2016 – Zyra për Informim Publik - <https://kk.rks-gov.net/malisheve/>



Pamje nga panairi në Qendrën e Kompetencës dhe nga realizimi i projekteve në Malishevë





Përmbajtja:

Komiteti për Komunitete mbajti mbledhjen e katërt të radhës	4
Kryetari dhe Komuna e Malishevës, me kohë e kanë publikuar raportin financiar	4
Kryetari Begaj, përgëzoi Lirindë Kafexhollin për suksesin në olimpiadën I-SWEEP	5
Kryetari Begaj, priti bashkatdhetarin Sheremet Kryeziu	6
Nxënësit e Qendrës së Kompetencës prezantuan njohuritë e tyre	7
U shënuan ditët e shkollave në Bardh, Llazicë dhe Turjakë	8
Kryetari Begaj, u njoftua me strategjinë e për parandalimin e ekstremizmit	8
Nxënësit e medresesë “Alauddin” në Prizren, dhanë shfaqje kulturore dhe artistike në Malishevë	9
Ka filluar aksioni i për largimin e deponive ilegale të mbeturinave	10
Komuna e Malishevës, përshëndeti vendimin e Gjykatës së Apelit, për ushtarët nga Malisheva	11
KO për shënimin e 16 Qershorit, mbajti takimin e parë	12
Rregullohen hapësirat publike në Malishevë	12
Filloi asfaltimi i rrugës Malishevë-Carrallukë	13
Komiteti për Politikë dhe Financa, mbajti mbledhjen e pestë të radhës	14
Shkolla “Rifat Berisha”, ka shënuar 53 vjetorin e saj	15
Përfunduan garat e volejbollit në nivelin e shkollave në Malishevë	15
Kryetari Begaj dhe Hidroregjioni jugor, mbajtën takim publik për investimet në ujësjellës	16
Komiteti për arsim, kulturë, rini dhe sport, mbajti takimin e radhës	17
Filloi asfaltimi i rrugëve në Mirushë	18
Filloi mbajtja e testit të arritshmerisë	18
Qeveria komunale, përshëndeti sukseset e nxënësve malishevas	19
Sh.F.M.U. “Hasan Prishtina”, shënoi 68 vjetorin e punës	20
Malisheva, pjesë e aksionit “Tas pastrojmë Kosovën”	20
Dëshmori Nuhi Krasniqi, u rivarros me nderime ushtarake	21
AKP, e kthen stacionin e autobusëve në pronësi të komunës	23
13 student malishevas të helmuar në Gjakovë	23
PDK në Malishevë, pamundësoi mbajtjen e seancës së Kuvendit të Komunës	24
Ekspozitë për nderë të vizitës së ambasadorit norvegjez	25
Krasniqi: Qarkorja e parë buxhetore është “qesharake”	26
Komiteti për Komunitete, vizitoi familjet e minoriteteve në Malishevë	27



Vazhdojnë përgatitjet për shënimin e 16 Qershorit	28
Të rinjve malishevas, ju mbahet ligjëratë kundër duhanit	28



Komiteti për Komunitete mbajti mbledhjen e katërt të radhës

Malishevë, 3 maj

Komiteti për Komunitete, organ i Kuvendit të Komunës së Malishevës, i kryesuar nga kryesuesi i komitetit, Labinot Gashi, ka mbajtur sot mbledhjen e katër të radhës për këtë vit, ku ka trajtuar dy raporte, atë të zyrës për komunitete dhe kthim dhe të shërbimeve publike. Në këtë mbledhje u njoftua edhe për ndryshimin e anëtarëve, ku në vend të Rifat Mazrekut, anëtare e këtij komiteti, nga sot është Floriana Demaj.

Pas miratimit të procesverbalit, zyrtarja për Komunitete dhe Kthim, Edona Krasniqi, paraqiti raportin e punës së zyrës. Sipas këtij raporti, duke u bazuar në të dhënat e këtij viti, janë riatdhesuar 30 persona. Ajo i ka sqaruar edhe për procedurat që të riatdhesuarit duhet të ndjekin për të realizuar përkrahje nga ana e ministrive përkatëse.

Ndërsa, zyrtari i drejtorisë së Shërbimeve Publike, Ismet Mazreku, duke e prezantuar raportin e punës së drejtorisë, tha se kërkesat më të shpeshta i kanë për strehim, ndërsa gjatë verës dhe vjeshtës, përballesh me kërkesa të shumta për ujë për pije.

Anëtarët e komitetit, kërkuan më shumë angazhim nga ana e drejtorisë për vendosjen e shenjave në komunikacion, sidomos në vendet ku ka lëvizje më të mëdha, siç janë shkollat apo ambulancat. Po ashtu kërkesë tjetër ishte edhe rregullimi i kanalizimit në fshatin Kijevë, ku edhe jetojnë komunitete pakicë.

Sqarim lidhur me shkrimin: KDI kritikon kryetarin Ragip Begaj për mostransparencë

Kryetari dhe Komuna e Malishevës, me kohë e kanë publikuar raportin financiar

Malishevë, 4 maj

Sot në portalin informativ “Malishevapress”, është publikuar një lajm, i cili bazohet në një komunikatë të Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), për mos publikim të raportit tremujor financiar dhe për mosraportim para Kuvendit të Komunës. Për të sqaruar edhe portalin në fjalë, KDI-në dhe më shumë për të sqaruar opinion e gjerë, jemi të obliguar të sqarojmë se kjo nuk qëndron, pasi kryetari Begaj dhe drejtorja për buxhet dhe financa, me kohë e kanë publikuar raportin tremujor financiar dhe me kohë e kanë paraqitur në Kuvendin e Komunës për raportim.



Në këtë shkrim të “Malishevapress” thuhet: Sipas KDI-së në listën e komunave të cilat nuk e kanë publikuar raportin financiar për tremujorin e parë të këtij viti bënë pjesë edhe Komuna e Malishevës.....

Ndërsa e vërteta është e kundërt, pasi Komuna e Malishevës, me datë 26.04.2016, e ka publikuar raportin tremujor financiar, në ueb faqen zyrtare të Komunës së Malishevës, pasi paraprakisht ky raport është proceduar me kohë në Kuvendin e Komunës (sëqarim: publikimi në ueb faqe, bëhet pasi raporti financiar procedohet në Kuvendin e Komunës). Ky raportim nuk është trajtuar në mbledhjen e fundit të KK-së, për shkak të agjendës së ngjeshur në mbledhjen e fundit, e cila është mbajtur më 29.04.2016. Futja apo mosfutja në rend dite e këtij raporti, është çështje e Kuvendit të Komunës dhe jo e qeverisë komunale.

Për të vërtetuar këtë, po ju përcjellim edhe linkun e publikimit të raportit, ku shihet edhe data e raportimit: <https://kk.rks-gov.net/malisheve/Dokumente/Raportet.aspx> .

Po ashtu ju bëjmë me dije, se çdo vit, në të gjitha raportet e organizatave monitoruese, Komuna e Malishevës, rendit ndër më të mirat në raportimet e saj financiare.

Kryetari Begaj, përgëzoi Lirindë Kafexhollin për suksesin në olimpiadën I-SWEEP

Malishevë, 5 maj

Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka pritur sot në një takim, Lirindë Kafexhollin, nga Bellanica, e cila është fituese e medaljes së bronzit në olimpiadën për kërkime shkencore I-SWEEP, të mbajtur në Teksas të SHBA-ve. Me këtë rast, kryetari Begaj, e ka uruar nxënësen Kafexholli, për suksesin e treguar në këtë olimpiadë dhe u shpreh i gatshëm të përkrahë të gjithë nxënësit dhe studentët malishevas, në këso lloj garash ndërkombëtare.



“I gëzohem suksesit që ke treguar në këtë olimpiadë, sikur i gëzohem edhe sukseseve tjera që të rinjtë tanë po tregojnë, sidomos në shkencë. Prandaj, ju uroj suksese edhe më tutje në garat tjera të diturisë dhe të dëshiroj sukses në studimet tuaja shkencore”, i ka thënë kryetari Begaj, Lirindë Kafexhollit, e cila ka zënë vendin e tretë në këtë garë të kërkimeve shkencore.



Kryetari Begaj, me këtë rast, shprehi gatishmërinë për të mbështetur të gjithë ata të rinj të Komunës së Malishevës, të cilët çdo ditë e më tepër po tregojnë rezultate në garat e njohurive, në të gjitha fushat, si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë ndërkombëtar.

Nga ana tjetër, Lirindë Kafexholli, ka falënderuar kryetarin Begaj, për përkrahjen e dhënë, për pjesëmarrje në këtë olimpiadë, si dhe pritjen që sot ja ka bërë.

Kryetari Begaj, priti bashkatdhetarin Sheremet Kryeziu

Malishevë, 5 maj



Në kuadër të takimeve me qytetarët dhe bashkatdhetarët tanë, kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka pritur sot, bashkatdhetarin Sheremet Kryeziun, i cili jeton dhe punon në Soest të Gjermanisë. Me këtë rast, kryetari Begaj, e ka falënderuar Kryeziun, për kontributin e tij dhe të bashkatdhetarëve tjerë, që jetojnë në këtë pjesë të Gjermanisë, për ndihmën në sigurimin e inventarit për shkollat tona.

“Gjatë vizitës në Gjermani, ju na keni ndihmuar jashtëzakonisht shumë, sikur dhe na keni shoqëruar gjatë tërë vizitës, dhe për këtë ju falënderoj. Ndihma që bashkatdhetarët tanë po japin, për familjet e tyre dhe për vendin në përgjithësi, është shumë e madhe dhe ne ju jemi mirënjohës për këtë”, tha kryetari Begaj. “Po ashtu gjatë vizitës së delegacionit nga Malisheva, në Soest, na keni përkrahur dhe falë kontributit të bashkatdhetarëve tanë, kemi arritur të krijojmë lidhje të mira me disa qytete të Gjermanisë”, tha kryetari Begaj.

Nga ana tjetër, bashkatdhetari Sheremet Kryeziu, tha se “është obligim i çdo qytetari, të punoj dhe të angazhohet për vendin e vet, pavarësisht se ku punon apo jeton”. Ai e falënderoi edhe kryetarin Begaj, për vizitën dhe takimet me bashkatdhetarët gjatë vizitës Gjermani. “Sa herë na vizitoni dhe na takoni në vendet ku jetojmë, ne ndihemi pjesë e pandashme e vendit, dhe kjo neve na shtynë të punojmë edhe më shumë për vendin dhe të japim kontributin tonë, në çdo mënyrë që kemi mundësi”, tha Kryeziu.



Nxënësit e Qendrës së Kompetencës prezantuan njohuritë e tyre

Malishevë, 6 maj



arritura.

Sot në Qendrën e Kompetencës “Kujtim Krasniqi” në Malishevë, është mbajtur aktiviteti tradicional i kësaj qendre të arsimit të mesëm profesional, “Dyert e hapura”, ku nxënësit e saj, i kanë prezantuar të arriturat e tyre, gjatë këtij viti shkollor. Në këtë aktivitet, mori pjesë edhe kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj dhe drejtori i arsimit, z.Avdi Morina, të cilët edhe i kanë uruar nxënësit dhe mësimdhënësit për këto të

Nxënësit e kësaj Qendrës së Kompetencës, i kanë prezantuar të arriturat e tyre në fushat e Administratës, Teknologjisë Informative (TIK), Hotelerisë dhe Turizmit, Logjistikës, Banka dhe shërbime të sigurimeve, dhe në Shitje dhe Marketing.

Nxënësit e këtyre drejtimeve, në këndet e krijuara, në formë të panairëve, i kanë prezantuar njohuritë e fituara gjatë këtij viti shkollor, si dhe i kanë prezantuar para të pranishmëve njohuritë e tyre në të gjitha drejtimet, që i ka kjo vatër e shkollimit profesional.

Me këtë rast, kryetari Begaj dhe drejtori Morina, i kanë uruar nxënësit dhe mësimdhënësit, duke i inkurajuar edhe për më shumë angazhim, në shfaqjen e njohurive të fituara, si dhe ju kanë dëshiruar suksese në të ardhmen.

Qendra e Kompetencës “Kujtim Krasniqi” në Malishevë, ka marrë pjesë edhe në panairë të ndryshme, ku i kanë prezantuar të arriturat e tyre në fushat në të cilat ata profesionalizohen.

Në fund të këtij aktiviteti, është mbajtur edhe një koktej rasti, me ushqime tradicionale, të përgatitur nga nxënësit e drejtimit të hotelerisë dhe turizmit.



U shënuan ditët e shkollave në Bardh, Llazicë dhe Turjakë

Malishevë, 6 maj

Shkollat fillore dhe të mesme të ulëta, në fshatrat Bardh, Llazicë dhe Turjakë, i kanë shënuar ditët e tyre. Të gjitha këto shkolla kanë përgatitur edhe programe artistike, si dhe i kanë shpalosur të arriturat e tyre. Në këto aktivitete, kanë marrë pjesë edhe nënkryetari i Komunës së Malishevës, z.Rexhep Mazreku, kryesuesi i KK të Malishevës, z.Aziz Thaçi, drejtori i arsimit, z.Avdi Morina dhe zyrtarë tjerë komunal.

Në të gjitha këto aktivitete, zyrtarët komunal, i kanë uruar me rastin e shënimit të ditëve të shkollave. Mazreku, Thaçi dhe Morina, përveç urimeve, kanë thënë, se “arsimi do të vazhdoj të mbetet prioritet e qeverisjes komunale, ku përmes investimeve konkrete, çdo ditë e më tepër po rritet edhe cilësia, dhe për këtë rritje të cilësisë, nxënësit tanë, po e tregojnë me rezultatet e mira që po arrijnë në garat e ndryshme të diturisë, përfshi edhe pjesëmarrja në gara ndërkombëtare, duke e përfaqësuar vendin”.

“Gjatë këtyre dy viteve, i kemi ndërtuar apo i kemi në ndërtim e sipër tetë institucione shkollore, dhe po ashtu jemi duke investuar edhe në infrastrukturën përcjellëse të shkollave, me qëllim të rritjes së cilësisë, mësimdhënies dhe mësimnxënies”, ka thënë nënkryetari Mazreku.

Kryetari Begaj, u njoftua me strategjinë e për parandalimin e ekstremizmit

Malishevë, 6 prill

Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka pritur sot në një takim informues, zyrtarët e lartë të Këshillit të Sigurisë të Kosovës, Bekim Podrimqaku-drejtor i Departamentit për Analizë dhe Politika të Sigurisë dhe Kujtim Bytyqin-analist për Politika të Sigurisë në këtë departament. Në këtë takim mori pjesë edhe komandanti i stacionit policor në Malishevë, kapiteni Halil Morina dhe drejtori i Drejtorisë për Arsim, Avdi Morina. Qëllim i takimit ishte informimi për strategjinë për parandalimin e ekstremizmit që shpie në terrorizëm.



Me këtë rast, zyrtarët e lartë të Këshillit të Sigurisë së Kosovës (KSK), Podrimqaku dhe Bytyqi, e kanë informuar kryetarin Begaj, për këtë strategji dhe për angazhimet e këtij këshilli, për parandalimin e ekstremizmit që shpie në terrorizëm.



Nga ana tjetër, kryetari Begaj, komandanti Morina dhe drejtori Morina, kanë ofruar mbështetjen e plotë të Komunës së Malishevës, për zbatimin e kësaj strategjie, si dhe u shprehën të gatshëm të bashkëpunojnë me KSK, për parandalimin e ekstremizmit.

Të dy palët u pajtuan, se duke u bazuar në të dhëna, në territorin e Komunës së Malishevës, nuk ka shqetësim për ekstremizëm të asnjë lloji, si dhe të dukurive tjera negative, por parandalimi është masa më e mirë, që të mos arrijmë në atë shkallë, si shoqëri.

Nxënësit e medresesë “Alauddin” në Prizren, dhanë shfaqje kulturore dhe artistike në Malishevë

Malishevë, 12 maj

Nxënësit e medresesë “Alauddin” në Prizren, sot kanë dhënë një shfaqje kulturore dhe artistike në shtëpinë e kulturës “Tahir Sinani” në Malishevë. Para fillimit të shfaqjes, u mbajtën edhe fjalime, ndërsa në këtë shfaqje, ishin të pranishëm edhe kryetari i Malishevës, Ragip Begaj, deputeti i Kuvendit të Kosovës, Enver Hoti, krerët e Bashkësisë Islame në Malishevë, të prirë nga Xhevat Kryeziu, ata të Prizrenit të prirë nga Ali Vezaj-kryeimam dhe Besim Berisha, komandanti i stacionit policor në Malishevë, kapiteni Morina, menaxhmenti i medresesë dhe qytetarë të shumtë.

Duke e përshëndetur këtë shfaqje të organizuar nga medreseja, i pari i Malishevës, Ragip Begaj, tha se “populli shqiptar gjithmonë është përpjekur dhe falë kësaj përpjekje dhe sakrificës së dëshmorëve, ne sot japim dhe shikojmë këto shfaqje, por këtë e bëjmë falë besimit që kemi. Ne gjithmonë kemi besuar dhe besimi na solli lirinë”.



Ndërsa sekretari i medresesë “Alauddin”, Fetah Bekolli, pasi i falënderoi të gjithë të pranishmit, foli edhe për përpjekjet e popullit shqiptar dhe kontributin e prijësve fetar në luftën çlirimtare. “Gjatë luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kanë rënë dëshmorë edhe 33 hoxhallarë”, tha Bekolli, i cili më pas foli edhe për rëndësinë e mësimin në medresenë “Alauddin”.

Fjalime të rastit kanë mbajtur edhe krerët e bashkësive islame të Malishevës dhe Prizrenit Xhevat Kryeziu dhe Besim Berisha, si dhe kryemami i Prizrenit Ali Vezaj.

Aktiviteti është hapur me antonimin e himnit kombëtar të interpretuar nga nxënësit e medresesë, ndërsa programi artistik u fillua me këngën për dëshmorin e kombit Tahir Sinani, e më pas u vazhdua me ilahi dhe recitale të përgatitur nga nxënësit e medresesë “Alauddin” në Prizren.

Ka filluar aksioni i për largimin e deponive ilegale të mbeturinave

Malishevë, 13 maj

Drejtoria e Shërbimeve Publike, në bashkëpunim me njësinë e “Ekoregjionit” në Malishevë,



kanë filluar aksionin për largimin e deponive ilegale të mbeturinave, në tërë territorin e Komunës së Malishevës. Sot është dita e tretë e këtij aksioni dhe brenda disa ditëve, pritet të largohen të gjitha pikat e evidentuara të grumbullimit ilegal të mbeturinave dhe në të njëjtën kohë ju bëhet thirrje qytetarëve, që të ruajnë ambientin.

Sipas drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Milazim Morina, “deri më sot janë pastruar këto fshatra: Mleqan, Plloqicë e epërme, Llazicë, Gollubovc, Plloqicë e poshtme, Bellanicë, Balincë, Drenoc dhe Shkarashnik”. Morina tha se, “drejtoria ka evidentuar 124 pika ilegale të grumbullimit të mbeturinave dhe brenda njëzet ditëve, pritet të përfundoj ky aksion”.



Drejtori Morina, i lut të gjithë qytetarët që të mos i hedhin mbeturinat në ambient, por ta ruajnë ambientin. Po ashtu drejtori Morina, kujton se përjashtuar tri fshatra të Komunës së Malishevës, të gjitha vendbanimet tjera janë nën menaxhimin njësisë së “Ekoregjonit” në Malishevë dhe mbeturinat largohen rregullisht.

“Edhe pse janë këto pika të evidentuara, mund të them se këtë vit, vërehet një dallim i konsiderueshëm me vitet tjera, pasi edhe pikat e evidentuara, edhe sasia e mbeturinave, janë dukshëm më pakta dhe kjo tregon se çdo ditë e më tepër po e ruajmë ambientin”, tha drejtori Morina, i cili gjithashtu tha se “nuk do të ndalen së punuari, edhe në forma të ndryshme vetëdijesimi, në mënyrë që ambienti që na rrethon të jetë i pastër”.

Komuna e Malishevës, përshëndeti vendimin e Gjykatës së Apelit, për ushtarët nga Malisheva

Malishevë, 16 maj

Sot në mbledhjen e rregullt të Qeverisë Komunale, Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, në fillim të kësaj mbledhje, ka përshëndetur vendimin e Gjykatës së Apelit, lidhur me rastin “Kleçka”, për lirim nga aktakuza për Fatmir Limajn dhe nëntë ushtarët tjerë të UÇK-së, të cilët kryesisht janë nga Komuna e Malishevës. “Me këtë vendim të Gjykatës së Apelit, për herë të pestë, për të njëjtin rast, u dëshmuua jo vetëm pafajësia, por edhe lufta e pastër e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”.

Përndryshe në mbledhjen e sotme, drejtorët e drejtorive, raportuan për punët dhe angazhimet e tyre, gjatë javës së shkuar dhe planifikimet për javën në vijim. Në këtë mbledhje, u bë e ditur se kanë filluar përgatitjet për shënimin e 16 Qershorit- Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevës, si dhe u tha se do të ketë aktivitete edhe me rastin e 1 Qershorit-Ditës së Fëmijëve.

Sa i përket realizimit të projekteve, sipas drejtorive komunale, të gjitha projektet nga lista e miratuar, e investimeve kapitale, do të përfundojnë sipas planifikimeve, si në infrastrukturë, bujqësi, arsim dhe në fusha të tjera.

Ndërsa për shërbimet administrative, u bë e ditur se janë mobilizuar për shkak të rritjes së numrit të personave që aplikojnë për pasaporta biometrike dhe të cilët kanë nevojë për nxjerrje të dokumenteve në shërbimin e gjendjes civile, si dhe janë përgatitur edhe për pritjen e bashkatdhetarëve, të cilët gjithashtu kanë nevojë për nxjerrjen e dokumenteve të ndryshme, dhe u



premtua se në maksimum, do të evitohen pritjet para sporteleve, sepse shërbimet do të jetë të shpejta.

KO për shënimin e 16 Qershorit, mbajti takimin e parë

Malishevë, 17 maj



Nën drejtimin e nënkryetarit të Komunës së Malishevës, Rexhep Mazreku, sot është mbajtur takimi i parë konstituiv i Këshillit Organizativ për shënimin e 16 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevës. Këshilli Organizativ për shënimin e 16 Qershorit, është formuar në mbledhjen e fundit të Kuvendit të Komunës.

Takimi i parë, është drejtuar nga nënkryetari Rexhep Mazreku, ndërsa anëtarë të këshillit janë: Kryetari i Komunës, Kryesuesi i KK-së, nga një përfaqësues i subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës së Malishevës (IQM (NISMA), PKD, LDK, LVV, AAK dhe AKR) dhe përfaqësues të Shoqatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së në Malishevë.

Pas konstituimit të Këshillit Organizativ, anëtarët e këtij këshilli, kanë biseduar edhe për fillimin e përgatitjeve për shënimin e datës më të rëndësishme për Komunën e Malishevës, ku të gjithë folësit, u shprehën për bashkëpunim dhe angazhim, në mënyrë që 16 Qershori, të shënohet në mënyrën më të mirë të mundshme, ashtu sikur edhe është rëndësia e kësaj date, ku në të njëjtën ditë shënohet çlirimi i Malishevës dhe shënohet Dita e dëshmorëve, që përkon me datën e rënies së dëshmorit të parë të Komunës së Malishevës, Imer Krasniqi, më 16 Qershor 1998 dhe rënies së dëshmorit fundit, Mentor Gashit, më 16 qershor 1999.

Rregullohen hapësirat publike në Malishevë

Malishevë, 18 maj

Në kuadër të mirëmbajtjes dhe rregullimit të parqeve publike dhe varrezave të dëshmorëve, Drejtoria e Shërbimeve Publike në Komunën e Malishevës, është duke e bërë rregullimin e tyre dhe mbjelljen me drunjë dekorativ, në mënyrë që qytetarët të kenë hapësira më të mira, si në parqe ashtu edhe tek varrezat e dëshmorëve. Hapësirat publike të rregulluara këtyre ditëve janë,



parku i qytetit në Malishevë, parku në Mirushë, hapësira afër pishinave në Banjë, varrezat e dëshmorëve në Malishevë dhe në Kleçkë.



Për këtë qëllim, sipas drejtorit të kësaj drejtorie, Milazim Morina, kjo drejtori, këtë vit, ka bërë pastrimin dhe ka mbjellë drunjë dekorativ, dhe në vende të caktuara kanë mbjellë edhe lule, në mënyrë që parqet të jenë sa më të përshtatshme për qytetarët që i vizitojnë këto parqe, apo kur vizitojnë varrezat e dëshmorëve në Malishevë dhe Kleçkë.

Sipas drejtorit Morina, këtë vit, mirëmbajtja dhe rregullimi i këtyre parqeve publike, kësaj drejtorisë e i ka kushtuar 5370 euro, ndërsa si drejtori do të vazhdojnë të mirëmbajnë parqet ekzistuese dhe kanë në plan edhe krijimin e parqeve tjera, varësisht nga nevoja.

Komuna e Malishevës, përkatësisht qyteti i Malishevës, njihet si një prej vendeve që ka më së shumti hapësira të gjelbëruara.

Filloi asfaltimi i rrugës Malishevë-Carrallukë

Malishevë, 18 maj

Ka filluar asfaltimi i rrugës Malishevë-Carrallukë, e gjatë rreth tri kilometra. Kjo rrugë, lidhet me rrugën Malishevë-Prishtinë dhe fillon nga varrezat e dëshmorëve në Malishevë dhe lidhet me lagjen e Krasniqëve në Carrllukë, ndërsa ishte njëra prej kërkesave të kamotshme të banorëve të këtij fshati, pasi kjo rrugë ka rëndësi edhe ekonomike për banorët, por edhe historike, pasi është prej rrugëve të rëndësishme të UÇK-së, që është shfrytëzuar gjatë luftës së fundit në Kosovë.





Punimet në asfaltimin e rrugës, i kanë parë nga afër edhe kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, i shoqëruar nga deputeti i Kuvendit të Kosovës, z.Enver Hoti dhe drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, z.Ahmet Morina, të cilët janë takuar kryetarin e fshatit, z.Rrustem Hoti, dhe me banorët tjerë të kësaj pjese të Carrallukës, të cilët i kanë uruara për rrugën.

“Jam shumë i kënaqur që sot po realizoj, njëren prej kërkesave më të rëndësishme të banorëve të Carrallukës dhe uroj që kjo rrugë, të jetë në shërbimin tuaj, pasi ky edhe është qëllimi ynë si institucion, që qytetarëve t’iu ofrojmë kushte sa më të mira për jetë”, ka thënë kryetari Begaj, me këtë rast.

Edhe deputeti Hoti, i ka uruar banorët, ndërsa kryetar i fshatit, Rrustem Hori dhe banorët e Carrallukës, e kanë falënderuar kryetarin Begaj dhe qeverinë komunale, për këtë investim kapital dhe shumë të rëndësishëm për banorët e fshatit, pasi kjo pjesë e rrugës, është prej rrugëve me më së shumti rëndësi për banorët, pasi përveç shkurtimit të rrugës, kjo zonë ka rëndësi të madhe edhe për zhvillimin ekonomik, pasi nga tani qasja është shumë e lehtë për të gjithë.

Sipas drejtorit të urbanizmit, Ahmet Morina, rruga është e gjatë 2760 metra dhe është duke u asfaltuar nga buxheti komunal i Malishevës, e që ka një shumë prej 125 395 Euro.

Komiteti për Politikë dhe Financa, mbajti mbledhjen e pestë të radhës

Malishevë, 18 maj

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), organ i Kuvendit të Komunës së Malishevë, i cili drejtohet nga kryesuesi i KK-së, z.Aziz Thaçi, ka mbajtur sot mbledhjen e pestë të radhës për këtë vit, ku ka shqyrtuar dy raporte, të cilat edhe i ka rekomanduar për shqyrtim në seancën e radhës së Kuvendit të Komunës.

Fillimisht, KPF, ka shqyrtuar raportin e të hyrave dhe shpenzimeve komunale për periudhën janar-mars 2016, ku para anëtarëve të KPF-së, këtë raport e ka prezantuar drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, z.Vesel Krasniq, ndërsa anëtarët e KPF-së, e kanë rekomanduar këtë raport tre mujor, për shqyrtim në mbledhjen e ardhshme të kuvendit.

Po ashtu për mbledhjen e ardhshme të kuvendit, është rekomanduar edhe raporti i punës së komisionit për ndarjen e bursave për student, për këtë vit. Më pas, KPF, ka shqyrtuar edhe kërkesat e ndryshme, të cilat i janë drejtuar këtij komiteti.



Shkolla “Rifat Berisha”, ka shënuar 53 vjetorin e saj

Malishevë, 18 maj

Shkolla Fillore dhe e Mesme e Ulët “Rifat Berisha”. Dje ka shënuar 53 vjetorin e saj. Në shënimin e ditës së shkollës, ka marrë pjesë edhe Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, bashkë me drejtorin komunal të arsimit, Avdi Morina, familjarë të Rifat Berishë, historian dhe shumë qytetarë të tjerë.

Në këtë shënim të ditës së shkollës, u fol për historinë e shkollës, si dhe për jetën dhe veprën e Rifat Berishës, i cili 67 vite më parë, u vra tradhtisht në një kurth të ngritur nga shteti komunist jugosllav, në Gajrak të Malishevës.

Në këtë ditë të shënuar, ishin prezent edhe familjarë të Rifat Berishës, të cilët që nga ajo kohë jetojnë në shtetin amë, Shqipërinë.

Përfunduan garat e volejbollit në nivelin e shkollave në Malishevë

Malishevë, 19 maj

Organizuar nga shoqata e Pedagogëve të Sportit në Malishevë, në bashkëpunim me Drejtorinë për Arsim dhe Edukim dhe Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, janë mbajtur garat komunale në nivelin e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta, për femra dhe meshkuj, ku vendet e para i kanë marrë shkollat “Vesel Pagarusha” nga Pagarusha dhe “Ismail Qemali” nga Bellanica.



Në ceremoninë e ndarjes së shpërblimeve kanë marrë pjesë edhe Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Blerta Krasniqi, të cilët edhe i kanë ndarë shpërblimet për më të mirët në këto gara, si dhe i kanë uruar më të mirët për suksesin e treguar.

Vendin e parë në kategorinë e femrave, e ka zënë sh.m.u. “Vesel Pagarusha” nga Pagarusha, të dytin sh.m.u. “17 Shkurti” nga Banja dhe vendin e tretë sh.m.u. “Ismail Qemali” nga Bellanica.



Në kategorinë e meshkujve, vendin e parë e ka zënë sh.m.u. “Ismail Qemali” nga Bellanica, të dytin sh.m.u “Xhevë Krasniqi” nga Drenoci dhe vendin e tretë sh.m.u.”Ibrahim Mazreku” nga Malisheva.

Sipas Adrian Telakut nga shoqata e Pedagogëve të Sportit, në këto gara kanë marrë pjesë 22 shkolla në kategorinë e femrave dhe po aq në kategorinë e meshkujve, kurse volejbollistja më e mirë u shpall Fatlinda Krasniqi nga sh.m.u “Vesel Pagarusha” dhe Granit Hoxha nga sh.m.u. “Ismail Qemali”.

Këto janë gara tradicionale që organizohen nga kjo shoqatë në bashkëpunim me drejtoritë përkatëse komunale.

Kryetari Begaj dhe Hidroregjioni jugor, mbajtën takim publik për investimet në ujësjellës

Malishevë, 20 maj



Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe zyrtarët e Hidroregjionit jugor, kanë mbajtur sot një takim informues me kryetar të fshatrave dhe qytetarë, lidhur me investimet në ndërtimin e ujësjellësit për 13 fshatra dhe projektit tjetër për rehabilitimin e 11 ujësjellësve ekzistues. Mjetet për këto investime, janë siguruar nga qeveria zvicerane, kurse përfutues do të jenë banorët e këtyre fshatrave të Komunës së Malishevës.

Fillimisht kryetari Begaj, i informoi të pranishmit për përpjekjet e komunës, deri në përfitimin e këtyre donacioneve, me qëllim të sigurimit të ujit për pije për banorët e rreth 25 fshatrave të Komunës së Malishevës. Bazuar në projektet, që janë pjesë e këtyre investimeve, përfutues për ndërtimin e ujësjellësit të ri, janë 13 fshatra, ku hynë Seniku, prej ku edhe do të furnizohen fshatrat tjerë, pastaj Tërpeza e ulët, Shkarashniku, një pjesë e Carrallukës, Drenoci (që tashmë e ka rrjetin e ujësjellësit), Bubaveci, Kijeva, Mleqani, Llazica, Vërmica, Balinca dhe dy Plloqicat. Ndërsa rehabilitimi i ujësjellësve ekzistues do të bëhet në 11 fshatra, përkatësisht në Astrazup, Dragobil, Maxharrë, Shkozë, Panorc, Rud, Tërpezë, Bellanicë, Guncat, Bardh dhe Kërvasari.



Me këtë rast, kryetari Begaj, kërkoi bashkëpunimin e të gjithëve, në mënyrë që këto projekte dhe ky investim kapital prej 1.5 milion euro, të realizohet në mënyrën më të mirë të mundshme.

Ndërsa Zenal Zenelaj, zyrtar i Hidroregjionit jugor, i ka sqaruar në detaje, projektet, duke i shpjeguar se brenda pak ditëve, do të dihet edhe përfituesi i tenderit për realizimin e projektit, ku do të shtrihen 90 kilometra ujësjellës të gypit kryesor dhe më pas edhe rrjeti dytësor, ndërsa këto projekte, bazuar në planet operative, pritet të përfundojnë brenda gjashtë muajve, pas fillimit të punimeve.

Nëse realizohen këto projekte, në territorin e Komunës së Malishevës, pritet të mbesin shtatë fshatra pa ujësjellës, në disa prej të cilëve, është gjetur uji, dhe pritet shumë shpejt të fillojnë ndërtimi i ujësjellësit edhe në këto fshatra.

Të pranishmit, në këtë takim publik, i kanë dhënë disa vërejtje, të cilat kryesisht kanë të bëjnë me çmimet e njehsorëve, të cilët duhet që vet qytetarët ti vendosin.

Komiteti për arsim, kulturë, rini dhe sport, mbajti takimin e radhës

Malishevë, 20 maj



Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, i drejtuar nga Januz Kastrati, ka mbajtur sot takimin e rregullt të këtij komiteti, ku janë trajtuar disa çështje, e në veçanti, përgatitjet për shënimin e 16 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevës.

Për këtë çështje, anëtarët e komitetit i ka informuar drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport, Blerta Krasniqi, sipas së cilës, drejtorja që drejton është angazhuar me të gjitha kapacitetet e saj, në shënimin sa më të mirë të datës më të rëndësishme për Malishevën. Sipas saj, drejtorja ka planifikuar disa aktivitete të cilat do të vendosen nga Këshilli Organizativ, ku përveç aktiviteteve të parapara për ditën e 16 Qershorit, paraprakisht do të zhvillohen edhe një varg aktiviteteve kulturore dhe sportive.

Në këtë mbledhje, kryesuesi i komitetit, Januz Kastrati i informoi anëtarët e komitetit, edhe me informatat që disponon, rreth punës së komisionit komunal për ndarjen e bursave për student, çështje e cila do të diskutohet në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës.



Pas mbledhjes, në kuadër të punës së tyre, anëtarët e komitetit, kanë vizituar edhe dy shkolla të Komunës së Malishevës, për tu njohur me kushtet dhe mbajtjen e procesit mësimor.

Filloi asfaltimi i rrugëve në Mirushë

Malishevë, 21 maj



Në kuadër të rregullimit të infrastrukturës rrugore në vendbanimet e Komunës së Malishevës, sot ka filluar asfaltimi i rrugëve, brenda fshatit Mirushë, përkatësisht asfaltimi i një pjese të rrugëve, e cila i lidh lagjet me rrugën kryesore të fshatit, dhe me rrugën Malishevë-Gurbardh. Asfaltimin e rrugëve në këtë fshat e ka përcjellë nga afër edhe kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj.

Kryetari Begaj, ishte i shoqëruar edhe nga drejtori i Drejtorisë së Urbanizimit, Ahmet Morina dhe drejtori i Drejtorisë për Ekonomi,

Buxhet dhe Financa, Vesel Krasniqi, të cilët përveç inspektimit të kryerjes së punimeve, janë takuar edhe banorët e kësaj pjese të Mirushës, të cilët i kanë uruar për rregullimin e rrugëve.

Rrugët që po asfaltohen sot në Mirushë, kanë qenë në pjesën me një pozitë jo të mirë, për shkak të thyerjes së terrenit dhe rrjedhimisht edhe qarkullimi i banorëve ka qenë i vështirësuar.

Sipas drejtorit për urbanizëm, Ahmet Morina, rrugët që po shtrohen sot në Mirushë, kanë një gjatësi prej 1.2 km dhe ky projekt është në kuadër të projekteve komunale, për rregullimin e infrastrukturës dhe financohet nga buxheti komunal i Komunës së Malishevës.

Filloi mbajtja e testit të arritshmerisë

Malishevë, 21 maj

Sot në Malishevë, sikur edhe në tërë vendin, ka filluar mbajtja e testit të arritshmerisë. Në Komunën e Malishevës, këtij testi do ti nënshtrohen 1402 nxënës, të cilët e kanë përfunduar klasën e nëntë, ndërsa ky test është duke u mbajtur në tri qendra shkollore, në sh.f.m.u. “Ibrahim Mazreku”, në Gjinnazin “Hamdi Berisha” dhe në Qendrën e Kompetencës “Kujtim Krasniqi”, të gjitha në Malishevë.



Sipas Enver Mazrekut, zyrtar në Drejtorinë Komunale për Arsim dhe Edukim, “testi i arritshmerisë ka filluar me kohë, në ora 10:00 dhe procesi është duke u zhvilluar në rregull dhe pa probleme”.

Testin e arritshmerisë në Komunën e Malishevës, është duke u administruar nga 125 administrator, ndërsa monitorohet nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Drejtoria Komunale për Arsim dhe Edukim.

Qeveria komunale, përshëndeti sukseset e nxënësve malishevas

Malishevë, 23 maj

Qeveria Komunale e Malishevës, në mbledhjen e rregullt, të së hënës, ka përshëndetur sukseset e nxënësve nga Malisheva, të treguara në garat sportive, sikur edhe sukseset tjera në lëmi të ndryshme. Në garat sportive në nivel të regjionit, në katër kategori të mundshme, shkollat e Komunës së Malishevës, kanë zënë tri vende të para, ndërsa edhe nxënësi Lendrit Jonuzaj, nga Seniku, është shpallur nxënësi më i mirë i gjimnazit “Hasan Nah” në Prizren. Po ashtu, janë përshëndetur edhe të gjithë nxënësit nga Malisheva, të cilët kanë treguar rezultate të mira në nivele të ndryshme të garave, duke e përfaqësuar Kosovën edhe jashtë vendit.

Përndryshe, në mbledhjen e sotme të qeverisë komunale, të drejtuar nga kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, u bë e ditur, se aktualisht, kanë përfunduar asfaltimet e rrugëve Malishevë-Carrallukë dhe rrugëve në Mirushë, ndërsa shumë shpejt pritet të përfundojnë edhe disa projekte tjera, të cilat në realizim e sipër.

Po ashtu, në mbledhjen e sotme, u fol edhe përgatitjet për shënimin e 16 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevës, ku janë paraparë një varg aktivitete, kulturore dhe sportive, pastaj aktivitetet tradicionale, si mbledhje solemne, homazhe, nderime dhe koncerte.



Sh.F.M.U. “Hasan Prishtina”, shënoi 68 vjetorin e punës

Malishevë, 23 maj

Shkolla Fillore dhe e Mesme e Ulët “Hasan Prishtina” në Tërpezë, ka shënuar sot 68 vjetorin e saj. Në shënim të kësaj date të rëndësishme për këtë shkollë, morën pjesë edhe kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, i shoqëruar nga zyrtarët e drejtorisë së arsimit, pastaj stërnipi i Hasan Prishtinës, Mehmet Prishtina, veteran të arsimit, nxënës dhe qytetar të shumtë.



“Hasan Prishtina është një njeri që ka bërë shumë për kombin. Ne e nderojmë dhe e respektojmë këtë kontribut, me emërtimin e institucioneve shkollore, sikur e kjo shkollë që mban emrin e tij. Ne duhet ta zhvillojmë dhe ta qojmë përpara arsimin dhe e kemi për obligim ti edukojmë brezat e rinj në frymën kombëtare”, tha në fjalën e rastit, kryetari Begaj.

Ndërsa stërnipi i Hasan Prishtinës, Mehmet Prishtina, duke i përshëndetur të pranishmit për ditën e shkollës, bëri thirrje për bashkim kombëtar, shpirtëror e territorial, si dhe bëri thirrje për ecjen përpara të ideologjisë së Hasan Prishtinës, apo siç e quajti ai, “hasannizmit”.

Ndërsa drejtoresha e shkollës, Emine Krasniqi, e paraqiti një historik të shkollës dhe foli për rezultatet e treguara të kësaj shkolle, gjatë një viti shkollor. Ajo gjithashtu i përshëndeti edhe shkollat me të cilat është e binjakëzuar kjo shkollë, me shkollën me të njëjtin emër në Prishtinë, Godancë dhe Llapushnik.

Drejtoresha e kësaj shkolle, me pas ka ndarë edhe mirënjohje për mësimdhënësit më të mirë, si dhe ka ndarë lëvdata për nxënësit më të mirë të sh.f.m.u. “Hasan Prishtina”.

Malisheva, pjesë e aksionit “Tas pastrojmë Kosovën”

Malishevë, 24 maj



Krahas vullnetarëve tjerë, si në tërë Kosovën, edhe në Malishevë, po zhvillohet aksioni “Ta pastrojmë Kosovën”, ku këtij aksioni, i janë përgjigjur rreth njëqind të rinj, kryesisht aktivist dhe vullnetar të Qendrës Rinore në Malishevë dhe nga Kuvendi i të Rinjve të Malishevës, ndërsa ky aksion është përkrahur nga drejtorja e Shërbimeve Publike dhe ajo për Kulturë, Rini dhe Sport. Këtyre të rinjve, ju është bashkuar edhe i pari i Malishevës,

Ragip Begaj, së bashku me drejtorët e drejtorive, Blerta Krasniqi, Milazim Morina, Sejdi Paçarizi dhe Hajdin Berisha.

Sipas drejtoreshës për kulturë, rini dhe sport. Blerta Krasniqi, të rinjtë vullnetar të organizatave rinore, i janë përgjigjur thirrjes për aksionin “Ta pastrojmë Kosovën”, e që arrin në numrin rreth njëqind të rinj.

Edhe drejtori i shërbimeve publike, Milazim Morina, tha se krahas të rinjve që kryesisht kanë qenë të organizuar në pastrimin e qytetit, të gjitha shkollat kanë qenë të njoftuara, dhe në një formë apo tjetër, kanë organizuar aksione të ngjashme në fshatrat e tyre.

Aksionit, po ashtu i janë bashkuar edhe njësisia e “Ekoregjionit” në Malishevë, të cilët përveç largimit të thasëve, kanë pastruar pjesët më të vështira, ku është e nevojshme përdorimi i makinerisë.

Drejtori i shërbimeve publike, Milazim Morina, bëri të ditur, se krahas këtij aksioni, është duke vazhduar aksioni tjetër i madh, i largimit të deponive ilegale, në vendbanimet ku janë evidentuar këto deponi, aksion të cilin është duke e kryer njësisia e “Ekoregjionit” në Malishevë.

Dëshmori Nuhi Krasniqi, u rivarros me nderime ushtarake

Malishevë, 26 maj

Sot, me nderime të larta ushtarake nga Forca e Sigurisë së Kosovës, u bë rivarrimi i dëshmorit Nuhi Krasniqi, i vrarë në gusht të vitit 1992, gjatë luftës në Kroaci. Dëshmori Nuhi Krasniqi është shpallur edhe hero në Kroaci, pasi kishte treguar trimëri dhe heroizëm, në mbrojtje të qyteteve kroate, gjatë luftës së fundit në këtë vend.



Paraprakisht, në shtëpinë e kulturës “Tahir Sinani” në Malishevë, është mbajtur një akademi përkujtimore, në nderim të dëshmorit Nuhi Krasniqi, e ku morën pjesë, kryetari i Malishevës, Ragip Begaj, ministri i veteranëve të Kroacisë, Tomo Medved, i shoqëruar edhe nga ministri i kulturës Zllatko Hasانبegoviç, ambasadorja kroate në Kosovës, Marija Kapitanoviç, zv/ministri i FSK-së, Fadil Gashi, deputet të Kuvendit të Kosovës, përfaqësues të organizatave të dala nga lufta në Kroaci, nga Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së, eprorë dhe ushtarak të FSK-së dhe të ushtrisë kroate, bashkëluftëtar të Nuhiut, familjarë e qytetarë të shumtë.

“Nuhiu, ju bashkua Gardës Ushtarake të Kroacisë, sikur edhe 2900 shqiptarë të tjerë, për të luftuar në mbrojtje të Kroacisë, përkrah kroatëve. Ai ra heroikisht, më 6 gusht të vitit 1992, duke ju bashkuar edhe 85 dëshmorëve të tjerë shqiptar, që jetonin në Kroaci, apo kishin braktisur ushtrinë e atëhershme jugosllave, e që kishin rënë front të luftës. Kosova dhe Kroacia, kishim një armik të përbashkët, por shqiptarët njihen edhe si komb që e do lirinë dhe që kanë ndihmuar edhe popujt tjerë në luftë liri. Dëshmia më e mirë është lufta në Kroaci, ku edhe ra heroikisht, dëshmori Nuhi Krasniqi”, tha mes tjerash në fjalën e tij, Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj.

Ndërsa ministri i Ministrisë së Veteranëve në Kroaci, Tomo Medved, tha se “shqiptarët i kanë dhënë Kroacisë shumë gjeneral e heronj. Një prej tyre është edhe Nuhi Krasniqi”. Ministri Medved, i cili ishte edhe i dërguari presidentes kroate, në këtë ceremoni, i falënderoi të gjithë shqiptarët, që morën pjesë në mbrojtje të Kroacisë. “Ne nuk i harrojmë kurrë, të gjithë ata që luftuan”, tha mes tjerash ministri Medved.

Zëvendësministri i Ministrisë së FSK-së, Fadil Gashi, nderimin që Kroacia po ju bën dëshmorëve shqiptar, e quajti “vlerësim të madh familjet e dëshmorëve dhe për shtetin e Kosovës”. Dekorimi që sot po i bëhet dëshmorëve shqiptar në luftën e Kroacisë, na bën të ndihemi krenar. Kjo është edhe një lidhje e fortë mes dy shteteve që luftuan kundër të njëjtit pushtues”, tha zv/ministri Gashi.

Në këtë akademi, në emër të Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së, foli edhe kryetari shoqatës Xhavit Jashari, tha se “ me këtë rivarrim dhe me këtë nderim, po e nderojmë rrugën e lirisë mes dy popujve”. Për biografinë e dëshmorit, foli Çerkin Dukolli, në emër edhe veteranëve të Malishevës. Dukolli, foli për jetën e Nuhiut, nga fëmijëria, deri në angazhimin e tij në Gardën Kroate, si dhe për heroizmat e treguar gjatë luftës në Kroaci, në mbrojtje të Zarës dhe qyteteve tjera kroate, deri në rënien e tij.

Tomë Kaçinari, kryetar i Bashkësisë të shoqatave vullnetare të Luftës Atdhetare në Kroaci, thë se “jeta e Nuhiut, është në themelet e Kroacisë. Rivarrimi i tij sot, është lidhje e rrugëve mes Kroacisë dhe Kosovës. Zoti e bekoftë shtetin e Kosovës dhe të Kroacisë”.



Ndërsa Gjeneral Major-Esad Çollaku, në emër të shoqatës së Veteranëve Shqiptar në Kroaci, tha se “lufta për çlirim është krenaria më e madhe, jo vetëm për një individ apo familje, por krenari e kombit. Ne jemi kalorësit modern të Skënderbeut dhe ndihemi krenar që kemi luftuar për lirinë e vendit, si në Kroaci, ashtu edhe në Kosovë”.

Pas fjalimeve, me urdhër të veçantë, bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kroacisë, u dekoruan me medalje familjet e dëshmorëve shqiptar në Kroaci. Këto medalje, me ceremoni ushtarake, familjeve të dëshmorëve Nuhi Krasniqi, Smet Bugojveci dhe Fadil Salihut, ju dha nga ministri i veteranëve në Kroaci, Tomo Medved.

Në emër të familjes së dëshmorit Nuhi Krasniqi, i ka falënderuar Gëzim Krasniqi.

Më pas me nderime të larta ushtarake nga Forca e Sigurisë së Kosovës, eshtrat e dëshmorit Nuhi Krasniqi, janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Brigadës 121 “Ismet Jashari-Kumanova” në Kleçkë.

AKP, e kthen stacionin e autobusëve në pronësi të komunës

Malishevë, 27 maj

Stacioni i Autobusëve në Malishevë, nga tani është në pronësi të komunës. Këtë e ka vendosur Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), pas shumë përpjekjeve të Komunës së Malishevës, që ky aset komunal, të bartet në pronësi të komunës. Këtë bartje të asetit komunal, e ka konfirmuar kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj.

Sipas kryetarit Begaj, pas mbledhjes së djeshme të AKP-së, anëtarët e këtij agjencioni, e kanë njoftuar lidhur me vendimin. “AKP ka shqyrtuar kërkesën tonë, për kalimin e stacionit të autobusëve në pronësi të komunës dhe ka vendosur, ashtu siç duhet, duke e bartur pronësinë”, ka thënë për Zyrën për Informim, kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj.

13 student malishevas të helmuar në Gjakovë

Malishevë, 27 maj

Në mesin e studentëve të helmuar, në konviktin e studentëve “Sadik Stavileci” në Gjakovë, janë edhe 13 studentë nga Komuna e Malishevës, ndërsa disa prej tyre janë në gjendje jo të mirë



shëndetësore. Sipas drejtorit komunal për shëndetësi, Hajdin Berisha, gjendja e studentëve malishevas, është jo e mirë.

Për këtë qëllim, drejtori Berisha, deri në orët e vona të natës së mbrëmshme, ka qëndruar në spitalin “Isa Grezda” në Gjakovë. Sipas tij, mbrëmë në këtë spital kanë qenë të shtrirë shtatë studentë nga Komuna e Malishevës, ndërsa gjendja shëndetësore e tyre, është jo e mirë dhe kanë shumë probleme pas helmimit.

“Deri sot në mëngjes, shtatë student malishevas janë të shtrirë në klinikën infektive të spitalit në Gjakovë, ndërsa tre student të tjerë, gjatë natës së mbrëmshme, në vazhdimësi janë trajtuar në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjarë në Malishevë, dhe gjendja e tyre është jo e mirë”, ka konfirmuar për Zyrën për Informim, drejtori i Drejtorisë për Shëndeti në Komunën e Malishevës, Hajdin Berisha.

Berisha ka thënë ”se me shqetësim janë duke e përcjellë këtë situatë të krijuar dhe janë në përcjellje të gjendjes së tyre shëndetësore, e cila aktualisht është shqetësuese” dhe në të njëjtën kohë, drejtori Berisha, kërkon ndriçimin e rastit, lidhur me helmimin e studentëve.

PDK në Malishevë, pamundësoi mbajtjen e seancës së Kuvendit të Komunës

Malishevë, 27 maj

Anëtarët e Kuvendit të Komunës, nga radhët e PDK-së, kanë bllokuar foltoren në sallën e kuvendit, duke e pamundësuar mbajtjen e seancës së rregullt të Kuvendit të Komunës së Malishevës. Bllokimi i foltores, sipas anëtarit të PDK-së, Vllaznim Kryeziu, arsyeja e bllokimit të foltores është mos vendosja e fotografisë së Presidentit të vendit, në sallën e KK-së.



Fillimisht, kryesuesi i KK të Malishevës, Aziz Thaçi, sqaroi se mos vendosja e fotografisë deri më tani është për shkaqe juridike dhe teknike, dhe sqaroi se është duke u munduar që ta rregulloj këtë çështje në vijë institucionale, përmes protokollit të shtetit, por që deri më tani ende nuk është rregulluar, pasi nuk ju është ofruar fotografia nga ana e protokollit të shtetit.



Pavarësisht kësaj, anëtarët e PDK-së, nuk janë larguar nga foltorja, ndërsa kryesuesi Thaçi, bëri një pauzë prej dhjetë minutave, për tu konsultuar me përfaqësuesit e subjekteve politike të përfaqësuara në KK të Malishevës.

Pas konsultës, në të cilën, sipas kryesuesit, nuk mori pjesë LDK-ja, por duke parë situatën e krijuar, tha se “nuk ka kushte për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit të Komunës dhe seancën e shpalli të mbyllur, kurse anëtarët e KK-së, do të njoftohen me kohë me mbajtjen e mbledhjes së pestë të rregullt të Kuvendit të Komunës”.

Ekspozitë për nderë të vizitës së ambasadorit norvegjez

Malishevë, 27 maj



Sot në Malishevë është hapur një ekspozitë kolektive e piktorëve dhe skulptorëve, nga të gjitha trojet shqiptare. Këto lloj ekspozitash, janë të shpeshta dhe tradicionale në Malishevë, mirëpo ekspozita e sotme, ishte e veçantë, pasi u hap për nderë të vizitës së ambasadorit norvegjez në Kosovë, shkëlqesisë së tij, z.Jan Braathu, i cili ka financuar rregullimin e ndriçimit të galerisë së ekspozitave në Shtëpinë e Kulturës “Tahir Sinani”

në Malishevë.

Fillimisht, ambasadorin Braathu, e ka prituri kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, kryesuesi i KK të Malishevës, z.Aziz Thaçi, drejtoresha për kulturë, rini dhe sport, znj.Blerta Krasniqi dhe drejtor tjerë komunal, ku kanë biseduar për bashkëpunimin me ambasadën norvegjeze dhe përkrahjen që kjo ambasadë, po i jep Malishevës, në vazhdimësi, përfshi edhe investimin fundit.

“Malisheva, përjetësisht i është mirënjohës shtetit norvegjez, pasi ka ndërtuar Qendrën e Kompetencës në Malishevë, e cila është jo thjesht një objekt, por një vepër e madhe në ngritjen e arsimit në Komunën e Malishevës”, tha kryetari Begaj, në hapjen e ekspozitës, ndërsa i përgëzoi edhe artistët vendas.

“Ndihem mirë që jam këtu në Malishevë dhe këto investime janë shenjë që shteti ynë ka ndihmuar dhe kontribuar për shtetin mik të Kosovës”, tha në fillim ambasadori Braathu. “Kultura



dhe arti, nuk janë vetëm për kryeqytetet, por të gjithë njerëzit, për të gjithë artdashësit, në çdo vend dhe arti duhet të shpërndahet në të gjitha qytetet”, tha Braathu.

Edhe drejtoresha për kulturë, rini dhe sport, Blerta Krasniqi, e ka falënderuar ambasadorin për donacionin, për rregullimin e ndriçimit në galerinë e ekspozitave në Malishevë.

Ekspozitën e sotme, e ka përkrahur Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, ndërsa pjesëmarrës, ishin artist nga të gjitha trojet shqiptare.

Jan Braathu, më pas ka vizituar edhe Qendrën Rinore në Malishevë, ku është njoftuar me kabinetet e kësaj qendre, si dhe me aktivitet që zhvillon Qendra Rinore.

Krasniqi: Qarkorja e parë buxhetore është “qesharake”

Malishevë, 30 maj

Nën drejtimin e kryetarit të Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, sot është mbajtur mbledhja e rregullt e Këshillit të Drejtorëve, ku në mesin e shumë çështjeve, drejtoritë janë njoftuar edhe me qarkoren e parë buxhetore për vitin 2017. Sipas drejtorit për buxhet dhe financa, Vesel Krasniqi, kjo qarkore, e përpiluar dhe e dërguar nga Ministria e Financave, është “qesharake”.

“Qarkorja e parë buxhetore, për vitin 2017, është e përgatitur në mënyrë jo profesionale nga ana e nivelit qendrorë dhe ka shumë defekte. E para, është dërguar me dhjetë ditë vonesë, që përbën shkelje, ndërsa planifikimi i nivelit qendrorë, është në kundërshtim me nevojat dhe mundësitë e Komunës së Malishevës. Edhe pse planifikohet të jetë rreth 500 mijë Euro më shumë buxhet se ky vit, ka shumë defekte, pasi planifikimi për të hyrat vetenake, është rritur, jashtë mundësive të komunës që ti realizoj ato, pastaj, 113 punëtorë janë planifikuar më tepër në listën e pagave. Defekt tjetër shumë absurd është edhe fakti se sipas kësaj qarkoreje, s’ka planifikim për shërbime komunale dhe projekte në arsim, por nga pesë kategori, i kanë futur vetëm pagat dhe mallra e shërbime në arsim, si dhe nuk është futur në planifikim edhe buxheti i Qendrës së Kompetencës. Është thjeshtë qesharake”, ka thënë drejtori për ekonomi, buxhet dhe financa, Vesel Krasniqi, gjatë prezantimit të qarkores së parë buxhetore, para drejtorëve të drejtorive komunale.



Përndryshe në mbledhjen e sotme të Këshillit të drejtorëve, u raportua për vazhdimin e shumë projekteve dhe pritjen e përfundimit të disa projekteve gjatë kësaj jave, siç janë rrugë, infrastrukturë përcjellëse shkollore, kanalizime, dhe disa projekte tjera në bujqësi.

Ndërsa u bë e ditur se janë bërë të gjitha përgatitjet për mbajtjen e testit të maturës 2016, pastaj për shënimin e 1 Qershorit të Ditës së Fëmijëve, si dhe po vazhdojnë përgatitjet për shënimin e 16 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevës.

Sa i përket situatës epidemiologjike, u bë e ditur se është në kontroll dhe me gjithë rastet e shtuara të pickimeve, tani pas ngrohjes së motit dhe punëve në fushë, nuk ka asnjë rast të infektuar. Po ashtu u tha se “këto ditë pritet të filloj edhe faza e dytë e dezinsketimit selektiv kundër rriqrave”. Kurse, sa i përket gjendjes së studentëve të helmuar në menzën e studentëve në Gjakovë, nga studentët e Komunës së Malishevës, mësohet se një student vazhdon të trajtohet në klinikën infektive në QKUK në Prishtinë.

Komiteti për Komunitete, vizitoi familjet e minoriteteve në Malishevë

Malishevë, 30 maj



Komiteti për Komunitete, i drejtuar nga kryesuesi i këtij komiteti, Labinot Gashi, ka mbajtur sot mbledhjen e pestë të radhës, ku temë kryesore ishte vizita në familjet e minoriteteve që jetojnë në Komunën e Malishevës, përkatësisht në Kijevë, Banjë dhe Malishevë. Hallet dhe problemet e komunitetit RAE, dolën të jenë, sikur edhe të shumicës së popullatës, infrastruktura dhe në një rast nevoja për banim.

Para mbledhjes, kryesuesi i komitetit, Labinot Gashi, bashkë me anëtarët tjerë të komitetit, kanë vizituar familjet e minoriteteve në Banjë dhe Malishevë, ndërsa ditë më parë janë vizituar edhe familjet në Kijevë. Sipas Gashit, në Kijevë, kryesisht problem paraqitet infrastruktura, përkatësisht vendosja e shenjave të komunikacionit në rrugë dhe kyçja në kanalizim, ndërsa Banjë, një familje ka nevojë për banim, pasi në kushtet ku jeton një familje me dy anëtarë, nuk janë të përshtatshme. Po ashtu në Malishevë, një familje ka nevojë për rregullim të hapësirës ku jetojnë.



Bazuar në bisedat me këta banorë, probleme tjera nuk kanë, pasi fëmijët shkollohen dhe janë të integruar në shoqëri, kurse nevojat i kanë sikur edhe e tërë popullata shumicë.

Vazhdojnë përgatitjet për shënimin e 16 Qershorit

Malishevë, 31 maj

Në kuadër të përgatitjeve për shënimin e 16 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevës, Këshilli Organizativ, i formuar nga Kuvendi i Komunës, e cili drejtohet nga Kryetari i Komunës, Ragip Begaj, ka mbajtur sot mbledhjen e dytë, ku janë diskutuar disa çështje organizative.

Me këtë rast, Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka kërkuar nga Këshilli Organizativ, dhe nga të gjithë faktorët tjerë, që në shënimin e kësaj date, ti lënë anash ngjyrimet politike, në mënyrë që 16 Qershori, të shënohet në mënyrën më të mirë të mundshme.

Përndryshe, përveç aktiviteteve tradicionale, pritet të ketë edhe shumë aktivitete tjera, e që lidhen me këtë datë.

Të rinjve malishevas, ju mbahet ligjëratë kundër duhanit

Malishevë, 31 maj

Me rastin e shënimit të Ditës ndërkombëtare kundër duhanit, organizuar nga Qendra Rinore në Malishevë, e përkrahur nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Shëndetësi, sot është mbajtur një aktivitet me të rinjtë, ku është mbajtur një ligjëratë për pasojat e përdorimit të duhanit dhe më pas janë shpërndarë mollë, në këmbim me cigare.

Pas hapjes së këtij aktiviteti, është mbajtur një ligjëratë nga ana e punëtorëve shëndetësorë të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Malishevë, për pasojat e përdorimit të duhanit, e më pas është zhvilluar edhe një debat lidhur me këtë temë, kurse në fund është bërë edhe shpërndarja e mollëve, duke i këmbyer me cigare.

Në këtë aktivitet, krahas të rinjve malishevas, kanë marrë pjesë edhe udhëheqësit e drejtorive, për kulturë, rini dhe sport, shëndetësi dhe për arsim e edukim, zyrtarë të Policës së Kosovës dhe vullnetar të Qendrës Rinore në Malishevë.



Buletini nr. 150-Maj- 2016- Zyra për Informim Publik - <https://kk.rks-gov.net/malisheve/>

